



Çfarë janë filmat për xham?

Filmat për xham janë filma/laminat prej poliestre transparentë ose me ngjyrë. Kryesisht filmat për xham përdoren për rritjen e cilësisë së xhamit duke ofruar izolim termik dhe ulje të shkëlqimit verbues të diellit, filtrim të rrezeve UV dhe sigurim privatësie. Mund të interpretohen dhe si filtra pasi lejojnë dritën por eliminojnë rrezet e këqia dhe kthejnë mbrapsht nxehtësinë e rrezeve të diellit.

Filmat për xham janë një metodë tepër efektive për uljen e ndjeshme të temperaturave në ambientet e banimit ku nxehtësia e rrezeve të diellit është e madhe. Teknologjia e re e prodhimit, përveç filmave metalikë, ofron dhe produkte të teknologjisë nano qeramike ku performanca e shkëlqyer ofrohet së bashku me transparencën/tejdukshmërinë perfekte!

Imagjinoni një xham tejësisht të tejdukshëm i veshur me një film transparent ku ju qëndroni brenda dhe lëkura nuk ju djeg aspak nga dielli!

Njerëzit keqkuptojnë "errësimin" konceptin mbi filmat për xhama pasi e lidhin me errësimin e xhamave të makinës.

Xham i errët nuk do të thotë = kontroll solar. Xham pasqyrë nuk do të thotë = kontroll solar. Që xhami të ketë kontroll solar apo 'termik' duhet të ketë një trajtim tepër special. Por si mund ta testosh nëse xhami yt është termik apo bllokues i rrezeve UV? Sigurisht me pajisje specifike dhe matës rrezesh UV.

Filmat për xham prodhohen dhe involvojnë një proces teknologjik tepër të avancuar. Përdorimi është shumë i gjerë në ndërtesa për të rritur efikasitetin e energjisë, mbrojtje nga rrezet UV si dhe rritje të sigurisë e privatësisë.




Kur dhe si instalohen filmat për xham

Filmat instalohen nga një skuadër e specializuar dhe çertifikuar prej kompanisë LLumar. Filmat instalohen direkt në shtëpinë, zyrën apo objektin tuaj pa hequr xhamin që kenë. Specialistët vijnë me materialet përkatëse dhe me delikatesë kryejnë instalimin e filmit në sipërfaqen e brendshme ose të jashtme të xhamit.

Filmat mund të instalohen dhe në punishten e xhamave e më pas janë gati për tu instaluar direkt në objekt. Thjeshtësia e montimit ofron fleksibilitet maksimal. Gjithashtu nëse një ditë vendosni të ndryshoni ngjyrën e xhamit, privatësinë apo modelin, përsëri mund të hiqet dhe zëvendësohet lehtësisht me një film të një ngjyre tjetër.

Struktura tipike e një filmi xhami

- a) shtresa e heqshme me veshje silikoni;
- b) shtresa e adezivit me bllokues të rrezeve UV;
- c) film i tejkushëm ose me ngjyrë prej poliestre;
- d) shtresë adezivi;
- e) shtresë e metalizuar ose qeramike për bllokim të nxehtësisë në një film transparent poliestre;
- f) veshje kundra gërvishtjes



LLumar RHE 20 SI ER HPR

Garancia – kohëzgjatja

Filmat për xham kanë patur një progres tepër të shpejtë gjatë dekadës së fundit e si rrjedhim kanë fituar reputacion të lartë për jetëgjatësinë ekstreme që shoqëron performancën e jashtëzakonshme. Shumë filma janë instaluar për më shumë se 15-20 vjet e përsëri janë në një gjendje të përkryer. Filmat profesionalë kanë një mirëmbajtje të thjeshtë normale dhe aspak të vështirë



Përse film për xhama? Komfort pa Kompromis!

- Jetoni në Shqipëri! Mesatarisht 2544 orë diell në vit.
- Rrisin performancën e xhamit që keni pa e ndërruar apo hequr atë!
- Nuk e besoni? Mund t'ju a provojmë me një test laboratorik pranë jush. Ne vijmë në shtëpinë, dyqanin ose zyrën tuaj.
- A nuk është mëkat të bllokosh me tendë apo grilë pamjen e mrekullueshme të ofruar nga fasada prej xhami e vilës në bregdet apo zyrës në katin e 20-të? Përse duhet të sakrifikosh bllokimin e plotë të dritës së diellit dhe pamjes kur mund t'i kesh të dyja dhe eliminosh vetëm nxehtësinë?
- Filmat profesionalë LLumar për apartamente, dyqane, bare e restorante, banka, spitale, shkolla, hotele, ofrojnë njëkohësisht transparencë/tejdukshmëri dhe bllokim të nxehtësisë së rrezeve të diellit.
- Kosto e pakrahasueshme e filmit profesional me një xham termik që ofron performancë identike. Testo xhamin termik, na testoni dhe ne! Sa është kostoja e ndërrimit të xhamit?
- Bllokim të nxehtësisë diellore + bllokim mbi 99% të rrezeve UV + ulje të ndjeshme të shkëlqimit verbues + rritje të sigurisë. Të gjitha në një film!
- Reduktojnë ndjeshëm temperaturën e brendshme të ambientit dhe rrjedhimisht ulin kostot e energjisë elektrike. Eficienca e energjisë është primare në ditët e sotme. Auditët profesionistë përlogarisin një ulje të konsiderueshme të kostos së faturës elektrike në vit në rastet e përdorimit të filmave LLumar nëpër ambiente të ndryshme.
- Filmat LLumar arrijnë të reflektojnë më tepër se 80% të energjisë diellore, kundërshtojnë mbi 99% të rrezeve të dëmshme Ultraviolet si dhe mund të rritin mbi 40% efikasitetin e izolimit termik të xhamit.
- Në një dritare, xhami zë më shumë se 80% të sipërfaqes dhe është pjesa më vulnerabël për humbjet e energjisë.
- Filmat LLumar ndihmojnë në realizimin e niveleve të komfortit të kërkuar sipas rregullave të sigurisë të vendit të punës "European Workplace Directive 89/654/EEC.
- Kushte optimale të punës
- Rritje e produktivitetit me më pak lodhje gjatë dimrit.



Mbrojtja nga rrezet UV

Dielli luan një rol thelbësor për jetën në tokë por shumë diell mund të jetë i pakëndshëm, madje edhe i dëmshëm. Rrezatimi UV i pafiltruar është shkatërrimtar, dhe jo vetëm për lëkurën e njeriut. Montimi i filmave specialë në sipërfaqen e xhamit ofron mbrojtje efektive kundër pasojave të dëmshme të diellit si në ndërtesa të reja edhe në ato ekzistuese.

Rrezet UV shkaktojnë çngjyrosje të pikturave, rrobave në dyqan, zverdhjen e plastikës. Filmat LLumar pengojnë rrezet UV deri në masën 99.9%. Kjo ju mundëson të mbani produkte në vitrinat e dyqaneve pa pasur probleme të venitjes së ngjyrave nga dielli. Filmat për mbrojtje nga rrezet UV përdoren edhe në muze, për të mbrojtur veprat e artit dhe objekte të tjera historike kulturore. Filmat LLumar mund të ulin në mënyrë të ndjeshme sasinë e rrezeve UV që arrijnë në trupin tonë. Në vendet perëndimore filmat përdoren gjerësisht në ambiente ku qëndrojnë fëmijë të vegjël, duke qënë se lëkura dhe sytë e tyre janë më të ndjeshëm.

Reth 86% e melanomes i atribuohet ekspozimit ndaj rrezeve ultraviolet (UV) – rezatimit nga dielli.

Melanoma është një prej tre kancerëve me rritje të vazhdueshme të vdekshmërisë tek meshkujt së bashku me kancerin e mëlçisë dhe ezofagut. Në çdo një orë në botë një person vdes nga melanoma. Filmat për xham janë të rekomanduar nga "Skin Cancer Foundation" dhe "British Skin Foundation" si pjesë e programit gjithpërfshirës për kujdesin ndaj lëkurës.

www.skincancer.org
www.britishskinfoundation.org.uk





Filmat e sigurisë

Xhami përdoret për të lejuar dritën dhe ngrohtësinë për të ndriçuar ndërtesat dhe përmirësuar estetikën. Përdoret gjithashtu edhe si pjesë strukturore për forcimin e ndërtesave. Megjithatë, shpeshherë mund të jetë i dëmshëm kur thyhet pasi është pjesa vulnerabël ndaj një sulmi. Fatmirësisht filmat cilësorë të sigurisë sigurojnë një metodë të lehtë për të modifikuar rezistencën e xhamit të thjeshtë ndaj një impakti aksidental. Filmat me performancë të lartë të sigurisë nga ana tjetër mund të rrisin rezistencën ndaj shpërthimeve të lëndëve plasëse apo impakteve të sulmeve të përsëritëshme.

Zakonisht filmat e sigurisë specifikohen për rezistencën ndaj shpërthimit sipas trashësisë dhe rezistencës ndaj impaktit në EN 12600. Tërë filmat e sigurisë kanë një adeziv lidhës tepër të fortë për tu lidhur me xhamin. Adezivi mban fort fragmentet e thyera të xhamit si dhe absorbon energji prej sulmit. EN 356 është testi standart i njohur për performancën dhe vlerësimin e filmit të sigurisë ndaj një sulmi manual.

Duke instaluar këta filma, ju mbron njerëzit nga copat e xhamit nëse ndodh që të thyhet. Kjo do të thotë që një xham edhe pasi të jetë vendosur në objekt, mund të përmirësohet me këta filma për të arritur standartet ligjore, EN 12600, (psh. në shkolla, kopshte, qendra të kujdesit shëndetësor, spitale, fabrika përpunimi ushqimorë, ambiente sportive apo ndërtesa publike). Sigurisht këta filma instalohen gjerësisht në vila private, ambasada, organizata të UN, banka ku elementi i sigurisë vlerësohet maksimalisht.

Duke përdorur filmat e sigurisë LLumar is you. Should be ju rrisni performancën e xhamit normal në nivelin e xhamit të laminuar sipas standarteve EN12600 dhe EN356 ose arritjen e kërkesave të GSA Niveli 1.

Mbi kompaninë:

Filmat LLumar prodhohen nga Eastman Chemical Company në SHBA. Eastman ka një prej fabrikave më të Is medha. Should be mëdha dhe më të integruara në botë për prodhimin e filmave me performancën më të lartë. Me më shumë se 60.000 m² hapësirë, fabrika e prodhimit ka kapacitet të mjaftueshëm, për të përmbushur nevojat e tregut me gamën më të gjerë të filmave për trajtimin profesional të xhamave. Me shumë se 50 vjet përvojë dhe zbatimimi i rreptë i kontrollit të cilësisë na sigurojnë cilësi të shkëlqyer, bazuar në të cilën produktet LLumar ofrojnë garanci më të gjatë se prodhuesit e tjerë në këtë industri duke qënë lider në tregun botëror. Filmat profesionalë dhe me cilësi të lartë LLumar, mund të gjenden të instaluar në shumë ndërtesa të njohura në të gjithë botën si Buckingham Palace apo Vatikan.

Marka LLumar u themelua në SH.B.A në vitin 1977 dhe më vonë u përhap në mbarë tregun botëror.

E-mail: info@llumar.al
Tel: +355 69 20 64426
[facebook.com/LLumarAlbania](https://www.facebook.com/LLumarAlbania)
www.llumar.al

Partneri juaj **LLumar** – www.llumar.al

EASTMAN



© 2016 Eastman Chemical Company. LLumar® and the LLumar® logo are trademarks of Eastman Chemical Company or one of its wholly owned subsidiaries. The ® used herein denotes registered trademark status in the US; marks referenced herein may also be registered internationally. Visual renderings are for illustrative purposes only; actual appearance of windows treated with film may vary. All rights reserved. No liability is accepted for errors. Version 1.00.0116 edited by Lordion Dengu.